



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, me 9 korrik 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Melihate Termkollli, Gani Geci, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu dhe Zulf Merxha.

Munguan: Agim Veliu, Bojan Stojanovič,

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend ditë:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 26 qershor 2008**
- 3. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me piken e parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 26 qershor 2008**

Kryesuesi, konstatoi se Procesverbali i mbledhjes së datës 12.06.2008, u miratua pa vërejtje.

- 3. Të ndryshme**

Kryesuesi njoftoi komisionin datë se me date 4 korrik, kryetaret e komisioneve kishin pasur një takim me Kryetarin e Kuvendit ku është diskutuar puna e komisioneve dhe është marr një vendim që në fund të çdo muaji të përgatitet një raport për punën e komisioneve, për mbledhjet e mbajtura dhe pjesëmarrjen e anëtareve

Kryesuesi pastaj njoftoi se Ligji për Sigurinë Private pritet të shkoje në lexim të dytë në seancën e radhës, kurse Projektligji për Armët është në komision por UNDP-ja ka kërkuar që për këtë projektligj të mbajmë një punëtori në javën e parë të shtatorit.

Naim Maloku theksoi se është miratuar nga Kryesia e Kuvendit Raporti me amendamente për Projektligjin për Sigurinë Private dhe tha se personalisht e përkrah idenë për organizimin e një punëtorie për Projektligjin për Armët. Ai theksoi se edhe ashtu muaji gusht është muaj i pushimeve dhe para shtatorit nuk mundet mu shqyrtu Projektligji.

Emrush Xhemajli tha se është e mirëseardhur ndihma nga UNDP-ja por duhet të shihet nëse është e nevojshme tash ky organizim i kësaj punëtorie.

Naim Maloku tha se e kupton atë se për çfarë po e potencon z. Emrush por ky do jete ligj me rëndësi të madhe pasi rregullon shitblerjen, prodhimin, tregtimin, lejen e mbajtjes kështu që lë të mbahet organizimi i kësaj punëtorie.

Eqrem Kryeziu duke u ndërlidhur me këtë tha se komisioni mund të kërkoj një plan dhe arsyet për mbajtjen e kësaj punëtorie.

Shkumbin Demaliaj i cili është edhe referues për këtë projektligj tha se komisioni veç ka mbajtur një dëgjim publik për projektligjin dhe do të shohim të gjitha mundësitë që kemi në dispozicion për shqyrtimin dhe amendamentimin e tij pasi ky ligj rregullon një fushe të rëndësishme të sigurisë.

Duke përmbyllur diskutimet për këtë çështje kryesuesi konstatoi: Që ti dërgohet një letër UNDP-se dhe të kërkohej që komisioni të njoftohet zyrtarisht me shkrim për qëllimin e organizimit të punëtorisë, kohën e mbajtjes, agjendën, dhe aspektet organizative.

Kryesuesi njoftoi se javën e kaluar në emër të Komisionit i kishte dërguar letër Koordinatorit të TMK-së Gjeneral Nick CAPLEN, ku kam kërkuar një takim mes tij dhe komisionit për tu njoftuar me proceset në TMK. Takimi besoj të mbahet gjatë korrikut.

Në fund të mbledhjes Kryesuesi tha se çdo ditë ka raportime se në pjesët e ndryshme të Kosovës ka probleme me vendosjen e rendit dhe sigurisë. Ne si komision mendoj të shqyrtojmë këtë situatë dhe ose të kërkojmë të debatohet në seance apo të dalim me rekomandime për situatën e sigurisë.

Naim Maloku tha se sa i përket kësaj me si komision kemi dy mundësi: Që të organizojmë një dëgjim publik me Institucionet e Sigurisë apo të kërkojmë që kjo çështje të behet në një seance por ju e pate për dy mocionet e fundit që ishin njëra për Letrën e

Banki Moonit dhe tjetra për strukturat paralele që nuk kaluan sepse ndonjëherë po krijohet përshtypja që parlamenti po diskutim çështje jashtë agjendës së tij.

Eqrem Kryeziu theksoi se do të duhej që para se komisioni të organizonte dëgjim apo paraqiste ndonjë mocion të kishte një vijë komunikimi mes Kryetarit të Komisionit dhe Kryeministrit apo edhe Presidentit se pse ta zame një çështje nuk mundet të jete e debatueshme në një kohe të caktuar.

Duke përmbyllur mbledhjen kryesuesi konstatoi: Deri në mbledhjen e radhës anëtarët e komisionit të shikojnë mundësitë ose për të bere disa rekomandime për situatën e sigurisë apo ndonjë propozim tjetër.

Mbledhja përfundoi në orën 12.20.

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit